

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Email/ Gjykata e Londrës i tërheq veshin Enea Karakaçit për konfliktin në Aeroportin e Vlorës
ADRESA	https://lapsi.al/emaili-gjykata-e-londres-i-terheq-veshin-enea-karakacit-per-konfliktin-ne-aeroportin-e-vlores-i1093996
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 10:42:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 10:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c2f01a56773a79268c22d025719aa6dc976562233e7696cab50d139a22669481
TEKSTI	388f7492449b07f7e078b28d052b31874001a77a08cdd3e0cb891e90a87d147c
PAMJA	236f5994999a7c576b7e7b5a2333c87550d3d6fed120247c124e3df657ab31cd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a40fcf6e6c321b5c9a2630226e268cf05b5709621b85b7b38deda571398623a3
E MËPARSHMJA	efb8c7b38a863caeb75467483f6c79d736540fd64bbea6a23d76fce3e742d6d9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a40fcf6e6c321b5c9a2630226e268cf05b5709621b85b7b38deda571398623a3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Emaili/ Gjykata e Londrës i tërheq veshin Enea Karakaçit për konfliktin në Aeroportin e Vlorës

Vetëm disa orë pasi MIE shpalli “fitoren” dhe sinjalizoi nxitimin drejt prishjes përfundimtare të koncesionit, arbitra Cecilia Carrara i rikujtoi qeverisë të mos ndërmarrë veprime që përkeqësojnë konfliktin, një sjellje që mund të marrë peshë kur përplasja për Aeroportin e Vlorës të gjykohet në themel



LAPSI.AL • 18 SEPTEMBER 2026



U shua shpejt entuziasmi në Ministrinë e Infrastrukturës për “fitoren” në Londër, në përballjen me kompanitë që kanë koncesionin e aeroportit të Vlorës. Disa orë pasi qeveria shpalli me tone triumfaliste se kishte fituar betejën e parë dhe se zgjidhja e kontratës së koncesionit kishte hyrë në fuqi, Cecilia Carrara, Arbitre e Emergjencës e caktuar në procedurën e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, u detyrua të rikthehet me një email, që ia prish festën Enea Karakaçit.

Rikujtesa që vjen nga gjykata e Londrës është e pazakontë. Nuk bëhet fjalë për një vendim të ri nga arbitrazhi, por thjesht për një thirrje për të pasur kujdes, për një vijë të kuqe që i vendoset zyrtarëve të shtetit shqiptar, të cilët dolën publikisht me vrullin për ta çuar më tej konfliktin për aeroportin.

Në Londër janë dy procedura arbitrazhi. Njëra është ajo e VIA-s, ku arbitri nuk pezulloi formalisht zgjidhjen e kontratës, por i ndaloi MIE-së të ushtronte të drejtat kryesore që burojnë prej saj: të hyjë e të marrë në posedim aeroportin, të marrë kontrollin operacional të aseteve, të kërkojë dorëzimin e pronave apo të zëvendësojë koncesionarin me një operator tjetër.

Lexo gjithashtu



17 SHTATOR, 13:33

Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyu SPAK për aeroportin e Vlorës

Tjetra është procedura e MABCO-s, aksionerit me 98% të VIA-s. Pikërisht në këtë çështje Carrara kishte nxjerrë urdhrin paraprak që i kërkonte qeverisë të mos

ide

**Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi**

Andi Bushati

**Gënjeshtër e rezortëve elitare**

Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

29°C

KËMBIMIEURO

91.65

aktuale

08:06

Seancë brenda, protestë jashtë/ Qytetarët zhvendosen para Kuvendit

08:02

**Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve****TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku

ndërmerrte veprimet që mund të përkeqesojnë komunikimin ose të rrezikojnë procedurën. Dhe pikërisht këtë urdhër arbitra e ndjeu të nevojshme ta ritheksonte përsëri me email.

Në emailin e dërguar palëve, Arbitrja e Emergjencës e caktuar në procedurën e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit i drejtohet direkt ministrisë së drejtuar nga Enea Karakaçi “që të mos pengojë Kërkesën Emergjente të paraqitur nga Aplikanti dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim gjatë zhvillimit të këtyre Procedurave të Arbitrit të Emergjencës lidhur me përfundimin e Kontratës së Koncesionit që do ta përkeqësonte këtë mosmarrëveshje ose do të rrezikonte këto procedura”.

Mesazhi nuk lë vend për keqkuptime. Ministria duhet të silltet në mënyrë të tillë, që të mos e bëjë të pavlefshme procedurën që po shqyrtohet në Londër. Kjo vjen sepse ministria e kishte paraqitur vendimin si “një fitore të rëndësishme”, duke theksuar se arbitri “rrëzoi tërësisht dy nga tri kërkesat e VIA-s” dhe se “zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi”.

Lexo gjithashtu



17 SHTATOR, 15:26

Gjykata bllokoi qeverinë për aeroportin e Vlorës/ Pacolli: Duam dialog për vazhdimin e punës!

Madje njoftimi shkonte një hap më tej. Sipas zyrtarëve të ministrisë, rrëzimi i kërkesave “konfirmon se mosmarrëveshja, në të cilën MIE do të vazhdojë të mbrojë me vendosmëri qëndrimin e saj, tani mund të kalojë menjëherë te tribunali i arbitrazhit”.

Pra, në vend të një sinjali për uljen e tensioneve dhe rikthimin te negociatat, Ministria e interpretoi rezultatin si dritë jeshile për ta thelluar konfliktin.

Nxitimi që mund t'i kushtojë Shqipërisë

Si sjellja e ministrisë, ashtu edhe mesazhi nga Londra vlejnë të anaizohen për të kuptuar çfarë mund të ndodhë në të ardhmen.

Historia e Aeroportit të Vlorës ka treguar se qeveria shqiptare që në nisje të konfliktit ka shfaqur një nxitim për ta çuar konfliktin drejt zgjidhjes së kontratës, drejt shpronësimit me çdo kusht, ndërkohë që pala tjetër pretendon se ka kërkuar vazhdimisht negociatat.

Edhe një ditë më parë, biznesmeni Behgjet Pacolli deklaroi se “nuk ka synuar zgjidhjen e kësaj çështjeje përmes arbitrazhit” duke shtuar se kompania kishte kërkuar bisedime dhe marrëveshje për vazhdimin e punimeve. Ai i kërkoi qeverisë “të zgjedhë dialogun dhe një zgjidhje të dakordësuar”. Por qëndrimi i tij krijon një kontrast të fortë me komunikimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila u shpreh entuziaste se çështja “tani mund të kalojë menjëherë te tribunali i arbitrazhit”.

Ky dallim mund të jetë i rëndësishëm në betejën që vjen. Gjykata Ndërkombëtare do të shqyrtojë mes të tjerave edhe sjelljen e palëve dhe provat që secila prej tyre do të paraqesë, dhe aty do të gjejë një ministri të papërmbytur për ta çuar kontratën drejt prishjes sa më parë dhe për t'ia dorëzuar aeroportin një pale tjetër që ende nuk ka dalë në skenë.

Edhe kreu i opozitës, Sali Berisha, e interpretoi politikisht këtë nxitim si pjesë të një plani për t'ia marrë projektin Pacollit. Në intervistën në Opinion ai deklaroi: “A e dini ju se dhe aeroportin e Vlorës do ia japë Yeffet-it. Nuk ka mbetur investitor i huaj në Shqipëri. I përzë një nga një”. Berisha shtoi se Pacolli “nuk ka pasur dëshirë të padisë Shqipërinë” dhe pretendoi se ekspozimi financiar mund të shkojë të paktën në 600 milionë euro.



Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyu SPAK për aeroportin e Vlorës



“Të plasi trapi...”, SMS-të e Ballukut në dosjen për aferën e Unazës së Tiranës



Haga, si përfundim i një epoqe të gjatë yes-man-izmi



Ndryshim rrënjësor në RTSH: Identiteti i ri, programe të reja dhe pesë superprodhime

Të kështilluara



Prishtinë/ Policia kërkon dokumentet e



identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë

Protesta e paralajmëruar në Prishtinë është shoqëruar me tensione dhe përplasje, pasi policia ka kërkuar dokumentet e l...



Në pritje të protestës madhështore për UÇK-në, Prishtina vishet kuq e zi

Sot në 18 shtator në mesditë sheshi kryesor në Prishtinë po merr pamje krejtësisht tjetër pasi është mbushur me fl...



Fier/ Përfshihet nga flakët automjeti në një parkim nëntokësor, banorët në panik



PDK pritet të dorëzojë sot në Kuvend nismën për ndryshimin e Ligjit për Specialen

Partia Demokratike e Kosovës pritet të dorëzojë sot në Kuvend propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dho...



Mitsotakis kërkon nga BE-ja uljen e taksave për karburantet

Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis e ka vendosur në fokus të qeverisë mbështetjen për qytetarët përballë rritjes së e...



Bardhi debat në Kuvend me kryeministrin Edi Rama : Ke projektuar një shtet privat

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka replikuar ashpër në Kuvend me kryeministrin Edi Rama për ligj...





Baste sportive pranë shkollave në Tiranë, arrestohen 2 persona dhe procedohen 2 të tjerë



Aksident në aksin Elbasan-Peqin, plagosen një grua dhe një fëmijë

Një automjet është përfshirë në një aksident këtë të premte. Mjeti është përplasur me barriera...



SPAK nisi hetimet për bllokimin e pagave të magjistratëve, merret në pyetje Drejtoresha e Thesarit

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), pasi nisi hetimet, ka nisur marrjen në pyetje të personave...



Breshri dëmtot zonat bujqësore të Korçës

Breshëri goditi disa prej zonave bujqësore të Korçës, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në sipërfaqet e mbje...

Me sytë katër



22:48


PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin pë...



PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

28:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

28:36



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.